30.2 Nëse një ngjarje e tillë ndodh, atëherë Çmimi i Kontratës do të rregullohet po ashtu.

### **PRANIMI DHE PËRGJEGJËSIA MBI DEFEKTET**

#### **Neni 31 Parimet e përgjithshme**

31.1 Verifikimi i punëve nga Autoriteti Kontraktues me qëllim të pranimit të përkohshëm ose final do të bëhet në prani të Kontraktuesit. Mungesa e kontraktuesit nuk do të jetë pengesë për verifikimin me kusht që Kontraktuesi të jete informuar prej të paktën 30 ditëve para datës së verifikimit.

#### **Neni 32 Testet për përfundimin**

32.1 Punët nuk do të pranohen deri sa të jene kryer verifikimet dhe testet e caktuara ne shpenzime të Kontraktuesit. Kontraktuesi duhet të njoftojë Autoritetin Kontraktues për datën në të cilën verifikimi dhe testet të tilla mund të fillojnë.

32.2 Punët te cilat nuk plotësojnë kushtet e kontratës, duhet, nëse kërkohet, të shkatërrohen dhe rindërtohen nga kontraktuesi ose te riparohen, sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktues, përndryshe kjo do të bëhet pas njoftimit të duhur në shpenzime të Kontraktuesit, me urdhër të Autoritetit Kontraktues.

#### **Neni 33 Pranimi i përkohshëm**

33.1 Punimet do të merren përsipër nga Autoriteti kontraktues kur të kenë kaluar në mënyrë të kënaqshme testet për pranim dhe te jete lëshuar, ose konsiderohet te jete lëshuar, një certifikatë e pranimit të përkohshëm.

33.2 Kontraktuesi mund të aplikojë, duke njoftuar Autoritetin Kontraktues, për një certifikatë të pranimit të përkohshëm jo më herët se 15 ditë para se punët, sipas mendimit te Kontraktuesit, te jene të gatshme për pranim të përkohshëm. Autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh pas pranimit të aplikacionit të Kontraktuesit ose:

- a) t'i lëshojë kontraktuesit certifikatën e pranimit të përkohshëm me një kopje për Autoritetin kontraktues duke thënë, nëse kjo është e përshtatshme, rezervat e tij, dhe përveç tjerash, edhe datën në të cilën sipas mendimit të tij janë përfunduar punët në pajtim me kontratën dhe janë të gatshme për pranim të përkohshëm; ose
- b) të refuzojë aplikacionin, duke i dhënë arsyet e tij dhe duke specifikuar veprimin të cilin, sipas mendimit të tij i kërkon nga Kontraktuesi për ta lëshuar certifikatën.

33.3 Nëse autoriteti kontraktues nuk arrin ose të lëshojë certifikatën e pranimit të përkohshëm ose të refuzojë furnizimet brenda një periudhe prej 30 ditësh, ai do të konsiderohet se ka lëshuar certifikatën në ditën e fundit të asaj periudhe.

33.4 Pas pranimit të përkohshëm të punëve, Kontraktuesi i çmonton dhe i heq strukturat e përkohshme dhe materialet që nuk kërkohen më për përdorim përkitazi me realizimin e kontratës. Ai gjithashtu do të heqë ndonjë mbeturinë apo pengesë dhe do të bëjë ndonjë ndryshim të gjendjes së vendit të pranimit siç kërkohen në kontratë.

#### **Neni 34 Përgjegjësia mbi Defektet**

34.1 Kontraktuesi do të jetë përgjegjës për mënjanimin e defekteve, ose dëmeve, në ndonjë pjesë të punëve të cilat mund të shfaqen apo shfaqen gjatë periudhës së defekteve dhe të cilat lindin nga ose:

- a) përdorimin i impiantit ose materialeve të dëmtuara ose mjeshtëria ose dizajni i gabueshme i Kontraktuesit; dhe / ose
- b) çdo veprim apo mosveprim i Kontraktuesit gjatë periudhës së defekteve.

34.2 Kontraktuesi me shpenzime të veta do ta përmirësojë defektin ose dëmin sa më shpejt të jetë e mundur. Periudha mbi përgjegjësinë e defekteve për të gjitha zëvendësimet ose rinovimet do të fillojë nga data kur zëvendësimi ose rinovimi është bërë për kënaqësinë e mbikëqyrësit. Nëse kontrata mundëson pranim të pjesshëm, periudha e defekteve do të vazhdohet vetëm për atë pjesë të punimeve e cila është ndikuar nga ndërrimi apo rinovim.

34.3 Nëse shfaqet ndonjë defekt ose ndodh ndonjë dëm gjatë periudhës së përmendur, autoriteti kontraktues ose menaxheri i projektit do ta njoftojnë Kontraktuesin. Nëse Kontraktuesi nuk arrin të korrigjoj një defekt ose një dëm brenda afatit kohor të përcaktuar në njoftim, autoriteti kontraktues mund të:

- a) të kryejë vetë punë, ose të punësojë dikë tjetër për kryerjen e punimeve, në rrezik dhe kosto të Kontraktuesit, në të cilin rast kostoja e shkaktuar nga autoriteti kontraktues do të zbritet nga pagesat e pritura ose nga garancitë që mbahen ndaj Kontraktuesit ose nga të dy; ose
- b) të ndërpresë kontratën.

34.4 Në raste urgjente, kur kontraktuesi nuk mund të arrihet menjëherë ose, pasi është arritur, nuk është në gjendje që të marrë masat e nevojshme, autoriteti kontraktues ose Menaxheri i projektit mund të kryejnë punën në kurriz të Kontraktuesit. Autoriteti kontraktues ose Menaxheri i projektit duhet të informojë sa më shpejt që të jetë e mundur Kontraktuesin për veprimin e marrë.

34.5 Periudha e përgjegjësisë së defekteve do të parashihet në KVK dhe specifikimet teknike. Nëse kohëzgjatja e periudhës së përgjegjësisë së defekteve nuk është e specifikuar, ajo do të jetë 365 ditë. Periudha e Përgjegjësisë së defekteve do të fillojë në datën e pranimin të përkohshëm.

#### **Neni 35 Pranimi përfundimtar**

35.1 Pas skadimit të periudhës së garancisë ose, në rastet kur ka më tepër se një periudhë, pas skadimit të periudhës së fundit, dhe atëherë kur të jenë zgjidhur të gjitha defektet apo dëmet, autoriteti kontraktues do t'i lëshojë Kontraktuesit një certifikatë të pranimin përfundimtar, me një kopje Autoritetit kontraktues, duke cekur datën në të cilën Kontraktuesi i ka plotësuar obligimet e tij sipas kontratës dhe në mënyrë të tillë që autoriteti kontraktues të jetë i kënaqur. Certifikata përfundimtare e pranimin do të lëshohet nga autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh nga skadimi i periudhës së garancisë ose menjëherë pasi riparimet eventuale që janë kërkuar sipas Nenit 34 të jenë përfunduar në mënyrë të tillë që të jetë i kënaqur autoriteti kontraktues.

35.2 Punët nuk do të konsiderohen se janë realizuar plotësisht derisa të jetë nënshkruar certifikata përfundimtare e pranimin nga Menaxheri i Projektet dhe të jete dorëzuar tek autoriteti kontraktues, e një kopje tek Kontraktuesi.

35.3 Pa marrë parasysh lëshimin e certifikatës përfundimtare, Kontraktuesi dhe autoriteti kontraktues do të mbeten të detyruar për plotësimin e obligimeve që dalin sipas kontratës para lëshimit të certifikatës përfundimtare të pranimin dhe të cilat kanë mbetur të përealizuara në kohën kur lëshohet certifikata përfundimtare e pranimin. Natyra dhe masa e obligimeve të tilla do të përcaktohen duke iu referuar dispozitivave të kontratës.

### **SHKELJA E KONTRATËS DHE SHKËPUTJA**

#### **Neni 36 Shkelja e kontratës**

36.1 Pala ka shkelë kontratën nëse nuk arrin të shlyejë ndonjë nga obligimet e veta me kontratën.

36.2 Në rastet kur ndodh një shkelje e kontratës, pala e dëmtuar do të ketë të drejtë për këto kompensime:

- a) dëmet; dhe/ose
- b) ndërprerjen e kontratës.

36.3 Përveç masave të sipërpërmendura, mund të jepen dëmshpërblime. Ato mund të jenë:

- a) dëme të përgjithshme; ose
- b) dëme të likuidueshme.

36.4 Mbulimi i dëmeve, pagesat apo shpenzimet që rezultojnë nga zbatimi i masave të parapara në këtë nen do të zbatohen duke u zbritur nga shumatat që duhet t'i paguhet Kontraktuesit, nga depozita, ose me pagesë nga siguria

### **Neni 37 Shkëputja e kontratës**

37.1 Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi mund të shkëpus Kontratën në qoftë se pala tjetër shkakton një shkelje themelore të Kontratës.

37.2 Shkelja themelore e kontratës do të përfshijnë, por nuk do të kufizohet në:

- a. Kontraktuesi ndërpre punën për 15 ditë rresht pa qenë e përfshirë kjo ndërprerje në programin e punës si dhe pa autorizim të menaxherit të projektit;
- b. Menaxheri i projektit urdhëron Kontraktuesin pa arsye të justifikuar të ndërpresë apo pezullojë aktivitetin e punëve të kontraktuara për më shumë se 15 ditë pune; ose marrëveshjet e arritura mbi pagesat për shkak të kontraktuesit për kosto të vonesës;
- c. Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi falimenton apo hyn në likuidim tjetër nga rindërtimi ose shkrirja;
- d. Pagesa e vërtetuar nga Menaxheri i Projektit, nuk paguhet nga Autoriteti Kontraktues brenda 30 ditësh nga data e certifikatës së Menaxherit të Projektit;
- e. Menaxheri i Projektit njofton se mos korrigjimi i defekteve është shkelje e kontratës dhe Kontraktuesi nuk arrin t'i korrigjoj brenda 30 ditëve të përcaktuara nga ana e Menaxherit të Projektit;
- f. Kontraktuesi vonohet në përbushjen e kontratës për numrin e ditëve për të cilat shumata minimale e dëmeve të likuiduara mund të paguhet.

37.3 Kur pala tjetër kontraktuese bën shkelje të kontratës për raste të tjera nga ato të parapara me Nenin 37.2, Menaxheri i Projektit do të vlerësojë nëse shkelja materiale e kontratës paraqet bazë për shkëputje të kontratës.

37.4 Nëse për shkak të fajit të palës së tretë krijohen rrethana emergjente objektive dhe kjo e pengon përbushjen e detyrimeve të kontratës, Menaxheri i Projektit me pëlqimin e Kontraktuesi do të përfundojë vazhdimësinë e përbushjes së punëve sa më pare që është e mundur. Menaxheri i Projektit do të bëjë vlerësimin e punës së kryer pjesërisht, do të kërkojë nga kontraktuesi të largohet nga zona e punës dhe ta lënë atë në një gjendje të mirë. Menaxheri i Projektit duhet të paguajë kontraktuesin për punët e kryera deri në momentin e marrjes së njoftimit me shkrim për ndërprerje.

37.5 Në qoftë se kontrata shkëputet, Kontraktuesi do të ndërpres punën menjëherë, do të siguroj vend punimin dhe ta liroj vend punimin brenda 15 ditëve nga përfundimi i periudhës së njoftimit.

### **Neni 38 Forca madhore**

38.1 "Force Madhore" siç përdoret këtu mendohet në çrregullimet industriale, çrregullimet civile, luftërat, eksplozimet, tërmeti, zjarret, vërshimet, epidemitë etj e shkaktuar jo me fajin apo neglizhimin e palëve kontraktuese, e paparashikueshme dhe jashtë kontrollit të palëve kontraktuese.

38.2 Në rast se ndodh ndonjëra nga ngjarjet që përcakton Forcën Madhore dhe kjo i bën të pamundur punëmarrësit kryerjen e obligimeve dhe përgjegjësisë të parapara me kontratë, punëmarrësi sa më shpejtë që është e mundur duhet t'i sigurojë punëdhënësit një deklaratë me shkrim me të dhënat e plota lidhur me ngjarjen. Në këtë rast aplikohen dispozitat si në vijim:

- i. Obligimet dhe përgjegjësitë e kontraktuesit do të pezullohen deri sa të arrihet niveli i mundësisë objektive së përbushjes së tyre.
- ii. Gjatë pezullimit dhe në lidhje me punët e pezulluara, të gjitha shpenzimet lidhur me riparimin e pajisjeve teknike, akomodimit të personelit dhe shpenzimet tjera të ngjashme i bart kontraktuesi.
- iii. Brenda pesëmbëdhjetë 15 ditë, duke llogaritur nga dita e ngjarjes që përcakton Forcën Madhore, Menaxheri i Projektit në bashkëpunim me Autoritetin Kontraktues duhet t'i vlerësojë të gjitha punët e përfunduara në mënyrë që Autoriteti Kontraktues ta paguajë kontraktuesin.
- iv. Afati për përbushje të obligimeve nga Kontraktuesi të detyrimeve të kontratës mund të zgjatet edhe për një periudhë për aq sa ka zgjatur periudha e pezullimit.
- v. Në qoftë se kontraktuesi për një kohë të gjatë është bërë i pa aftë, për shkak të Forcës Madhore, për t'i kryer obligimet dhe përgjegjësitë e parapara me kontratë, Autoriteti Kontraktues brenda shtatë 7 ditë mund ta njoftojë me shkrim kontraktuesin për ndërprerjen e kontratës.

### **Neni 39**            **Pagesa pas shkëputjes së kontratës**

39.1 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të shkeljes materiale të kontratës nga ana e kontraktuesit, Menaxheri Projektues do të përpilojë shkresën mbi vlerësimin e punës së përfunduar dhe materialet e porositura duke i llogaritur ato me minus pagesat në avans që janë marrë para datës së lëshimit të shkresës në fjalë dhe minus përqindjen e vlerësuar të punëve të pakryera, siç është cekur në KVK. Dëmet shtesë të likuidimit nuk do të aplikohen. Nëse shuma totale e borxhit të Autoritetit Kontraktues tejkalon ndonjë pagesë si borxh ndaj kontraktuesit, diferenca do të jetë obligim borxhi ndaj Autoritetit Kontraktues.

39.2 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të interesit të Autoritetit Kontraktues ose shkeljes materiale bazë të kontratës nga Autoriteti Kontraktues, Menaxheri i Projektit do të lëshoj një certifikatë për vlerën e punës së bërë, materialet e porositura, koston e arsyeshme të heqjes së Pajisjeve, riadhesimin e personelit të Kontraktuesit i punësuar vetëm për Punët, shpenzimet e Kontraktuesit për mbrojtjen dhe sigurimin e Punëve dhe pagesat në avans të marra deri në datën e certifikatës.

### **Neni 40**            **Prona**

40.1 Të gjitha materialet dhe pajisjet e ndërtimit në vend punim, Impiantet, Punët e Përkohshme, dhe Punët do të konsiderohen të jenë pronë e Autoritetit Kontraktues nëse Kontrata ndërpritet për shkak të gabimit të Kontraktuesit.

### **Neni 41**            **Lirimi nga Ekzekutimi**

41.1 Në qoftë se pamundësohet përbushja e kontratës nga shpërthimi i luftës apo ndonjë rasti tjetër jashtë kontrollit të Autoritetit Kontraktues ose Kontraktuesit, Menaxheri i Projektit do të vërtetojë këtë. Kontraktuesi do të sigurojë vend punimin dhe do të ndërpres punën sa më shpejt që është e mundur pas pranimit të këtij vërtetimi dhe do të paguhet për punët e kryera para pranimit të tij dhe për punët e kryera më pas për të cilat është arritur marrëveshje.

## **ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE**

### **Neni 42**            **Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve**

42.1 Palët do t'i bëjnë të gjitha përpjekjet për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, Palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për pozitën e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado Palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse Pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

42.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpiqen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

### **Neni 43**            **Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore**

43.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- a) ose vendim nga gjyqi;
- b) kurdo që palët pajtohen vendim arbitrimi në pajtim me KVK.

43.2 Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

### PJESA III E KONTRATES kushtet e veçanta

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

*[Udhëzimet për plotësimin e KVK janë dhënë, sipas nevojës, në shënimet kursive të përmendura për nenet përkatëse të KPK. Fshini ato jo relevante]*

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Neni. Nr.	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	<b>Gjuha e përdorur do të jetë gjuhët në përdorim zyrtarë shqipe</b>
Siguria e ekzekutimit	10.1	Shume e sigurisë së ekzekutimit është 10 % e vlerës së kontratës ose 2,883.30 € me validitet prej 30 ditëve nga data e kompletimit të kontratës, ose deri me date 20.09.2026.
Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit	11.2	Shuma minimale e sigurimit do të jetë: (a) Për humbje ose dëmtim të Punëve, Impianteve dhe Materialeve <i>[shëno shumat]</i> ; (b) humbje ose dëmtim i Pajisjeve <i>[shëno shumat]</i> ; (c) humbje ose dëmtim i pronës (përveç Punëve, Impianteve, Materialeve dhe Pajisjeve) në lidhje me Kontratën <i>[shëno shumat]</i> ; (d) dëmtim personal ose vdekje: (i) të punëtorëve të Kontraktuesit: <i>[shëno shumat]</i> (ii) të personave të tjerë: <i>[shëno shumat]</i>
Programi	12.1	<b>Planin për Menaxhimin e Kontratës.</b>  Kontraktuesi do ta dorëzojë për aprovim Programin për Punët brenda <b>5 ditëve</b> nga data e nënshkrimit të kontratës
	12.2	<b>Periudha për Programin e azhurnuar është 5 ditë nga data e pranimit të kërkesës së Menaxherit të projektit</b>
Fillimi i punëve	17.1	<b>Data e fillimit do të jetë : 10.06.2026</b>
	17.2	Data e përfundimit e të gjitha Punëve do të jetë: <b>70 ditë kalendarike, ose deri me date 20.08.2026</b>
Dëmet e likuiduara	19.1	Norma e dëmeve të likuiduara është 0.25 % e Çmimit final të Kontratës në ditë.  Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për tërë kontratën është 10% të çmimit final të kontratës
Regjistri i punës	20.1	<b>Një regjistër i punës do të mbahet nga ana e kontraktuesit</b>
Inspektimi dhe testimi	22.1	<b>Inspektimi i cilësisë dhe sasisë së punëve do të bëhet në momentin e dorëzimit që janë lëndë e kësaj kontrate, nga Organit mbikëqyrës- menaxherit të projektit të punëve – i emëruar nga ana e Zyrtarit Kryesor Administrativ të Autoritetit Kontraktues.</b>  <b>Asnjë furnizim i mallit respektivisht asnjë ekzekutim i</b>

		<p>punëve-shërbimeve nuk do të konsiderohet valid dhe i pranuar, deri sa nuk konfirmohet cilësia dhe sasia, nga ana e Organit mbikëqyrës- menaxherit të projektit të punëve - të Autoritetit Kontraktues.</p> <p>Xhylbehar Taipi -caktohet udheheqes I ekipit menagjues te kontrates, nga AK</p> <p><b>Dreni Myrtezani</b>-anetar I ekipit,</p> <p><b>Vetim Hasani</b>-anetar I ekipit</p> <p>Menagjer i kontrates nga OE eshte: Elvis Spahiu</p>
Pagesat		<p>Sipas Raportit të prezantuar – dorëzuar nga Menaxheri i Projektit- situacioneve të aprovuara nga ana e Organit mbikëqyrës- menaxherit të projektit, pagesa do të kryhet në afate sa më të shkurtë kohor dhe jo më gjatë se 30 ditë nga data e pranimit dhe evidentimit të faturës, kurse pjesa tjetër e kontratës do të realizohet pas perfundimit te punimeve te percjellura me raport nga ana e menaxherit te kontrates dhe raportit nga ana e komisionit te pranimit teknik te projektit.</p>
Parapagimi	26.1	Shuma e Parapagimit është: <b>Nuk ka pagesë paraprake.</b>
Mbajtja e Parasë	27.1	Shuma e parave të mbajtura është: <b>E vlerës së kontratës.</b>
Shkaqet për kompensim	30.1	Data e posedimit të vend punimit do të jetë <b>5 ditë</b> pas nënshkrimit të kontratës.
Përgjegjësia mbi Defektet	34.5	Periudha garantuese e defekteve është <b>[shëno numrin]</b> ditë
Pagesa pas shkëputjes së kontratës	39.1	<p>Periudha garantuese e defekteve është : <b>12 muaj</b> nga data e pranimit teknik të përkohshëm.</p> <p>Dokumenti Polisa e sigurimit të kualiteti e lëshuar nga një Bank apo kompani e sigurimeve e licensuar nga Banka Qendrore e Kosovës <b>10 %</b> vleren e pergjithshme të kontratës, me afat validiteti për prej <b>12 muaj</b> nga data e pranimit teknik të përkohshëm.</p>
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve	42.2	Palët do të tentojnë që ti zgjidhin mosmarrëveshjet në mënyrë miqësore. Sapo te shfaqet ndonjë mosmarrëveshje palët do ta njoftojnë njëra tjetrën me shkrim për pozitën e mosmarrëveshjes dhe do ti sugjerojnë palës tjetër mbi variantin e zgjidhjes së kësaj mosmarrëveshje.
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore	43.1	a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në <b>Gjykatën Komerciale në Prishtinë</b> , në pajtim me ligjin në Kosovë

Ndërtimi i infrastruktures rrugore në vendin Studence dhe Befriçev në fshatin Iverson

KRSTEC I POSHTËM					
A	KUBEZIMI I RRUGËVE AKSELS 325.000				
Të gjitha punët në përputhje me normat teknike dhe standardet Europiane dhe Europodit. Kompania punë kryese është përgjegjëse për furnizimin e materialeve mbrojtëse dhe të sigurisë punështet me mjete të specializuara para fillimit të punës, nëgjithë zonen ku do të zhvillojë aktivitetin e saj. Të gjitha demtonet, instalimeve nëntokësore të qytetarëve është e obliguar të kthejë në gjendje të mëparshme me kosto të vetën financiare					
I PUNËT PREGADITORE					
Nr.	Përshkrimi i punëve	Njësia	Sasia	Çmimi njësi me TVSH (€)	Çmimi total me TVSH (€)
1.1	Shënim i kantierit me shenja rrezik në zonat ku do të punohet te infrastruktura rrugore sipas projektit detaj gjatë kohës sa zgjat punimet Llog në m2	m2	325.00	0.10 €	32.50 €
1.2	Identifikim instalimeve nëntokësore dhe mbrojtëse (tipesjelles, kanalizimi, instalimet rrymes, instalimet telefonike dhe internet), piketimi dhe regjistrimi në ditarin ndërtimor, me qëllim të evitimit parandalimin dëmtimeve eventuale mund të ndikojë në rrezikimin e personelit. Në këtë pozicion përfshihet edhe plani i situacionit të rrjetit ekzistues me qëllim që të hartohet plani i veprimtari për shkyrje dhe demofon të rrjetit ekzistues pasurim e terreni dhe pregaditjen e kushteve teknike të përgjithshme për ndërtimin dhe kubezimin e kubezave në rrugët lokale të fshatit. Llog në m2	m2	325.00	0.10 €	32.50 €
1.3	Shënim dhe inçizimet geoderike në zonat dhe segmentet rrugore ku do të punohet sipas projektit detaj gjatë kohës sa zgjat punimet Llog në m2	m2	325.00	0.10 €	32.50 €
Gjithsej: Pos 1					97.50 €

II PUNËT ZOKËSORE					
Nr.	Përshkrimi i punëve	Njësia	Sasia	Çmimi njësi me TVSH (€)	Çmimi total me TVSH (€)
Qendruesja gjërimit dhe largimi i dhurat të kat III -V dhe makina ndërtimore në vendet e projektuar për nivelizimin dhe zgjerimin dhe rregullimin e rrugës lokale me trashësi t = 20 deri në 40 cm. Në këtë pozicion përfshihet edhe nivelizimi terreni me ranjet e çubur duke përfshirë edhe elementet tjera përcjellëse të përcaktuar në projekt sipas kushteve teknike dhe përgjithshme, si dhe detajeve teknike. Largimi i dhurat të gornat në deponis të cilës e cakton investitori. Llog në m2 me të gjitha shpenzimet.					
2.1	Çermeti me makineri (70%)	m3	91.00	2.00 €	182.00 €
2.2	Çermeti me dorë (20%)	m3	76.00	2.00 €	152.00 €
2.3	Çermeti me çekan (10%)	m3	13.00	2.00 €	26.00 €
2.4	Planifikimi dhe pëntimi i bazamentit të rrugës para se të vendosen shiresat e tazonit Llog me të gjitha shpenzimet	m2	325.00	0.50 €	162.50 €
Gjithsej: Pos 2					422.50 €



*Prunij*

III PUNIMET E MBUSHJES (TAMPON)					
Nr.	Përshkrimi I punëve	Njësia	Sasia	Çmimi njësi me TVSH (€)	Çmimi total me TVSH (€)
	Furnizimi, transporti, shtrirja, nivelizimi i ngjeshja dhe punimi i shtresës së rrugës me gurë të thyer nga materiali guror i fraksionit 0-121 mm me trashësi të shtresës t=20 cm si dhe ngjeshja e tij me cilindër vibrues deri sa të ftohet moduli i ngjeshjes Mv=500 kg/cm <sup>2</sup> . Materiali i përdorur duhet të jetë i pasur me ateste paraprake dhe atë sipas normave dhe standardeve. Vrejtje: Pas përfundimit të kësaj shtrese kompania punëkrejtë është e obliguar ta shqyrtojë testin e modulit të ngjeshjes dhe ta prezentojë tek menaxheri kontratës.				
3.1	Furnizimi dhe punimi i shtresës rrugëve me gurë të thyer fraksion 0-63 mm t=20cm	m <sup>3</sup>	65.00	8.00 €	520.00 €
	Furnizimi, transporti, shtrirja, nivelizimi i bazës dhe punimi i bazës së rrugës, me material guror nga gurit të thyer fraksionit 0-121 mm me trashësi të shtresës t=10 cm si dhe ngjeshja e tij me cilindër vibrues. Materiali i përdorur duhet të jetë i pasur me ateste paraprake dhe atë sipas normave dhe standardeve. Ngjeshja deri sa të ftohet moduli i ngjeshjes Mv=500 kg/cm <sup>2</sup> . Vrejtje: Pas përfundimit të kësaj shtrese kompania punëkrejtë është e obliguar ta shqyrtojë testin e modulit të ngjeshjes dhe ta prezentojë tek menaxheri kontratës.				
3.2	Furnizimi dhe punimi i shtresës rrugëve me gurë të thyer fraksion 0-31.5 mm, t= 10 cm	m <sup>3</sup>	32.50	10.00 €	325.00 €
	Furnizimi, transporti, shtrirja dhe punimi i shtresës rrafshuese me rere të imët nga gurit të thyer fraksion 0-4mm, me trashësi të shtresës t=5 cm si dhe ngjeshja e tij me cilindër vibrues deri sa të ftohet moduli i ngjeshjes Mv=500 kg/cm <sup>2</sup> . Sqarim: Pas përfundimit të kësaj shtrese kompani punëkrejtë është e obliguar ta shqyrtojë testin moduli të ngjeshjes dhe ta prezentojë tek menaxheri kontratës.				
3.3	Furnizimi dhe punimi i shtresës rrugëve me gurë të thyer fraksion 0-4 mm t= 5 cm	m <sup>3</sup>	16.25	10.00 €	162.50 €
Gjithsej: Pos 3					1,007.50 €

IV PUNIMET E MBISTRUKTURËS RRUGËS ME ELEMENTE BETONO-MONTUESE					
Nr.	Përshkrimi I punëve	Njësia	Sasia	Çmimi njësi me TVSH (€)	Çmimi total me TVSH (€)
	Furnizimi, transporti dhe montimi i elementeve nga betoni, floqaritur të gjitha punimet e nevojshme, nga betoni i klasës C-30/37, d=8cm, forma e gjeometrisë së kubëzave kompenzimi, e përcaktuar nga investitori në çmim të parashtet edhe furnizimi, transporti dhe shpërndarja e rrezes (filerit) për mbushjen e fugave në sipërfaqen e cila është e kubëzuar. Vrejtje: Rreza e cila kubëzohet në tërësi të sipërfaqes zgjeruese prej muri në murë kur nuk ka gurë skajor performancë i kubëzave bëhet me beton në tërësi të rrezes të shprehur në m <sup>2</sup> në dy anët e rrugës përfaqësojnë perimetri të rrugës.				
4.1	Furnizimi, Transporti dhe montimi i kubëzave të betonit me t=8cm, duke floqaritur në çmim edhe mbushjen e fugave me rrezë filer	m <sup>2</sup>	325.00	13.00 €	4,225.00 €
4.2	Furnizimi dhe montimi i skajoreve nga betoni C-30/37 dim (15x25x80) cm, me bazë betoni floqaritur me të gjitha punimet e tjera të nevojshme.	m	80.00	12.00 €	960.00 €
Gjithsej: Pos 4					5,185.00 €

**KUBËZIMI I RRUGËVE AKSIALES=325.0 m<sup>2</sup>**

I	PUNËT PREGADITORE				97.50 €
II	PUNIMET TOKËSORE				422.50 €
III	PUNIMET E MBUSHJES (TAMPON)				1,007.50 €
IV	PUNIMET E MBISTRUKTURËS RRUGËS ME ELEMENTE BETONO-MONTUESE				5,185.00 €
TOTALI (A)					6,712.50 €

**B NDËRTIMI I MURIN MBROJTËS NË SEGMENTIN I; L=11.00 m'; H=3.00m**

PUNËT PARAPREGADITORE					
Nr.	Përshkrimi I punëve	Njësia	Sasia	Çmimi njësi me TVSH (€)	Çmimi total me TVSH (€)
I.1	Sënim i kantierit me shenja rreziku në zonat ku do të punohet të në infrastrukturë përcjellëse sipas projektit detaj gjatë kohës së zgjatit punimet i log në m <sup>2</sup>	m <sup>2</sup>	11.00	0.10 €	1.10 €



1.2	Identifikimi dhe dislokimi i perçorave nentokësore dhe mbulesore (tirasime elektrike, injezditës, kanalizim). Në këtë pozicion përfitohet edhe plani i situacionit të rrjetit ekzistues me qëllim që të hartohet plani i veprimit për shkytyje dhe demolin të rrjetit ekzistues, pastrimin e teretit dhe pregaditjen e kushteve teknike të përgjithshme për ndërtimin e murit mbrojtës dhe punimin e rruges me kubezave Llog m2. Vërejtje në rast se nga pakujdesia vjen deri të demimit eventuale të gjitha shpenzimet i bartë kompania punëkryese der në samitin e gjendjes.	m <sup>2</sup>	11.00	1.00 €	11.00 €
1.3	Furnizimi, transportimi dhe montimi i tavolinës së armatuesve së bashku me mbulesën përkatëse. Të njëjta duhet të demontohet pas përfundimit të punimeve Llog në m1	m <sup>2</sup>	12.00	1.00 €	12.00 €
1.4	Luçizimi i teretit si dhe përcjellja e punimeve gjeodezike gjatë ekzekutimit Llog në m <sup>2</sup> .	m <sup>2</sup>	11.00	1.00 €	11.00 €
<b>Gjithsej punë 1:</b>					<b>25.20 €</b>



*Pruning*

PUNËT TOKËSORI					
Nr.	Përshkrimi i punëve	Njësia	Sasia	Çmimi njësi me TVSH (€)	Çmimi total me TVSH (€)
	Punëmatrësi është i detyruar që të gjitha materialet e demoluara sipas planit të prodhimit (materiali i kampionit) të punohen apo të transportohen deri në deponinë e caktuar për depozitimin e materialeve. Materialet që i nevojiten Investitorit duhet të depozitohen në depot e parashikuar për grumbullimin e materialit në depot të cilën e cakton Investitori.				
2.1	Pastrimi i terrenit drunjte shkurret, materiale rrethore rrethore, në gjithë perimetrin ku do të zhvillohen punimet. Në çmim kalkulohet edhe bartja e materialit të demouar deri te deponia që e cakton organ mbikëqyrës. 1.1og. Në m <sup>2</sup>	m <sup>2</sup>	11.00	2.00 €	22.00 €
2.2	Germimi i dheut (themeleve) i kategorise së III-IV te me makina ndërtimore dhe me vegla dore. material i tepër i cili mbetet pas mbushjes deponohet me transport në deponinë të cilën e cakton investitori. 1.1og. Në m <sup>3</sup>	m <sup>3</sup>	66.00	2.00 €	132.00 €
2.3	Formësimi dhe ngjeshja e nenbazes se themelet te murit mbrojtës es me ngjeshmeri 30MN/m2. 1.1og. Në m <sup>2</sup>	m <sup>2</sup>	19.80	2.00 €	39.60 €
2.4	Sigurimi i gropës se germuar nga rrëshqitja e dheut si dhe vendosja e shenjave të sigurisë konform normave ndërtimore në fuqi. 1.1og. Në m <sup>2</sup>	m <sup>2</sup>	11.00	2.00 €	22.00 €
<b>Gjithsej punë II:</b>					<b>215.60 €</b>

PUNËT E MBUSHJES					
Nr.	Përshkrimi i punëve	Njësia	Sasia	Çmimi njësi me TVSH (€)	Çmimi total me TVSH (€)
3.1	Furnizimi shtrirja dhe ngjeshja e tamponit Ø-63mm nën bazën e themelet me trashësi t=25cm me ngjeshmeri 30MN/m2. 1.1og. në m <sup>3</sup>	m <sup>3</sup>	5.50	8.00 €	44.00 €
3.2	Furnizimi dhe mbushja mbësapa murit me zhyrtor te pastër te lunt 63 mm ne tarr Gjafësin dhe lartësuar e murit M5=50 cm 1.1og. në m <sup>3</sup>	m <sup>3</sup>	9.90	15.00 €	148.50 €
3.3	Furnizimi dhe montimi i gypit te drezatit PVC Ø100 mm prapa murit. 1.1og. në m <sup>2</sup>	m <sup>2</sup>	20.00	3.00 €	60.00 €
3.4	Furnizimi si dhe punimi i Gypit PVC Ø 70 mm per kullon e murit mbrojtës nga betoni i armuar. çdo 2.6 m. 1.1og. në m <sup>2</sup>	m <sup>2</sup>	11.00	2.00 €	22.00 €
3.5	Furnizimi dhe mbushja mbësapa murit me mac dheun e germuar në shtresa deri ne 20 cm dhe me ngjeshje. 1.1og. në m <sup>3</sup>	m <sup>3</sup>	25.00	5.00 €	125.00 €
<b>Gjithsej punë III:</b>					<b>399.50 €</b>

PUNËT E BETONIT DHE RYTONARITES					
Nr.	Përshkrimi i punëve	Njësia	Sasia	Çmimi njësi me TVSH (€)	Çmimi total me TVSH (€)
	Të gjitha pozicionet e strukturave të betonit duhet të realizohen, sipas dimensioneve, dhe sipas llojit dhe klasës së betonit, dhe në sipas dokumentacionit Teknik të projektimit, llogaritjes statike dhe detajeve të armaturës. Betonit për të gjithë llojet e punimeve duhet të prodhohet, transportohet, punohet, mirëmbahet dhe testohet sipas parashikimeve të përcaktuara në rregullat e zbatueshme. "Rregullat për Standardet Teknike për Beton dhe Beton të Armuar (PBAH). Të gjitha panellet (kallepet) e pjeseve te dukshme te betonit te lyhen dhe te jene te kualiteti te larte ne menyre qe te permbushen edhe kriteriet e larta vizual-estetike te sferfaqeve te betonuara. Betonit per betonimin e mureve dhe shtytave te jashtme, prapa te cilave behen mbushje e argjaturat dhe shtohet hidroizolimi vertikal me shtimin e aditiveve te papershkueshesiu nga uji. Kallepet dhe platformat, mbështetja duhet të bëhen në bazë të dimensioneve të parashikuara në mënyrë të shkathët dhe cilësore, në mënyrë që pas betonimit dhe çmonimit të punimeve të mos ndodhin as deformimi me i vogël në strukture. Gjatë betonimit strukturat konstruktive pas ndërprerjeve të nevojshme të betonimeve, lidhja dhe vazhdimi duhet të pastrohen së pari, sipërfaqja duhet të jetë e ashpër, shpëlarje dhe pastaj të betonohet vazhdimi. Llogaritja e sasive të punimeve të kryera në të vërtetë nga njësitë e dhëna të masës (libri i ndërtimit) Çmimi njësi i secilit pozicion të këtyre punimeve nërshihet gjithëkës që është e nevojshme deri në përfundimin e së pjetës.				
4.1	Furnizimi, transporti dhe punimi i shtresës rrafshuese, betonimi i themeleve te murit mbrojtës nga betoni i thjeshtë C12/15 me trashësi 5 cm, në çmim të llogaritët mirëmbajtja e betonit. Punimi Sipas detalit te dhënë. 1.1og. në m <sup>3</sup>	m <sup>3</sup>	1.02	50.00 €	50.88 €
4.2	Furnizimi, transporti dhe betonimi i themeleve te murit mbrojtës nga betoni i armuar C25/30. Në çmim llogaritët kallupimi me drresa, betonit, duket shtuar shtesa aditivit per papershkrushmeri nga uji, duke vibruar dhe respektuar dhe mirëmbajtja e betonit. Punimet te ktyhen Sipas detalit te dhënë. 1.1og. në m <sup>3</sup>	m <sup>3</sup>	7.92	100.00 €	792.00 €



54,00

4.3	<p>Emozioni transporti dhe betonimi i murit mbrojtës me dritë sipas zgjidhjes teknike të prezantuar dhe lartësi , nga betoni i armuar C25/30.Në çmim fletaritet kallupimi me drasë, si dhe betonimi duke i shtuar shtesa aditivë nga pa përshkrueshmëri e ujit , vibrator dhe respektuar shtrësitë mbrojtëse Punimet të kështu siç është detajuar te dhe në 1.10e në m3</p>	m	9.90	100.000	9900.000
Gjithsej punë IV :					1.832.880

1833



*Pruning*

PUNËT E ARMATURËS					
Nr.	Përshkrimi i punëve	Njësia	Sasia	Çmimi njësi me TVSH (%)	Çmimi total me TVSH (€)
	Të gjitha lojet e armaturave duhet të pastrohen nga idryshliu, baltë dhe gëlqerim përta, lakuri dhe vendosin suksesisht mbi lojet e statike dhe detajeve të armatures. Para betonimit, ornatu mbrojtës duhet të krahë shteguesit e shteguesve të armaturave. Çmimi mëdij secilit pozicion të këtyre punimeve përfshin gjithçka që është e nevojshme deri në performimin e secilit lojë të armaturave të përfunduar sipas detaleve në projekt. Armatura S-500.				
5.1	Furnizimi i hekurit ndërmor, pastrimi, prerja, përpunimi dhe montimi i armatures të hekurit të brinjëzuar të klasës S 400/500, të gjitha në përputhje me llogaritjen statike sipas detaleve teknike të armimit të përfshira në projekt. Llogaritja në kg.	kg	1,135.97	0.8	908.78 €
Gjithsej punë V:					908.78 € J
<b>B REKAPITULLIMI I PUNIMEVE PËR MËRIN MBROJTËS NE SEGMENTIN I</b>					
I	PUNËT PARAPREGADITORE				25.20 € J
II	PUNËT TOKESORE				215.60 € J
III	PUNËT E MBUSHJES				399.50 € J
IV	PUNËT E BETONIT DHE BETONARMËS				1.832.88 € J 33,00
V	PUNËT E ARMIMIT				908.78 € J
TOTALI (B)					3.381.95 €



3322,08  
*Pring*


**C** NDËRTIMI I MURIT MBROJTËS NË SEGMENTIN 2 : L=15.50 m<sup>2</sup>;H=3.00m

PUNËT PARAPREGADITORE					
Nr.	Përshkrimi i punëve	Njësia	Sasia	Çmimi njësi me TVSH (€)	Çmimi total me TVSH (€)
1.1	Shënimet e kampionit me shenja reziku në zonat ku do të punohet te në infrastrukturë përcjellëse sipas projektit detaj. gjatë kohës së zgjerimit punimet .Llog në m <sup>2</sup>	m <sup>2</sup>	15.50	0.10 €	1.55 €
1.2	Identifikimi dhe dislokimi i perçojave nëntokësore dhe mbrojtësore (Insulime elektrike , ujësjellës ,kanalizimi ). Në këtë pozicion përfshihet edhe plani i situacionit të rrjetit ekzistues me qëllim që të hartohet plani i veprimtimit për shkyqje dhe demolim të rrjetit ekzistues pastrimin e terrenit dhe pregaditjen e koshleve teknike të përgjithshme për ndërtimin e murit mbrojtës dhe punimin e rrugës me kubezave 1.10 m <sup>2</sup> . Vërejtje në rast se nga pakujdesia vjen deri të dëmtimi eventuale të gjitha shpenzimet i bartë kompania punëkryese der në sanimin e gjodjes.	m <sup>2</sup>	15.50	0.10 €	1.55 €
1.3	Inçizimi i terrenit si dhe përcjellja e punimeve gjeodezike gjatë ekzekutimit 1.10 m <sup>2</sup>	m <sup>2</sup>	15.50	0.10 €	1.55 €
<b>Gjithsej punë I:</b>					<b>4.65 €</b>

PUNËT TOKËSORE					
Nr.	Përshkrimi i punëve	Njësia	Sasia	Çmimi njësi me TVSH (€)	Çmimi total me TVSH (€)
Punëmatrësi është i detyruar që të gjitha materialit e demoluara (sipas pos. të postshëmara) të largojë nga punështja apo të transportojë deri në deponinë e caktuar për deponim materialësh. Materialit që i rrethojnë investatorit duhet të deponohen në depot e parapara për grumbullim të materialit në depot të cilën e cakton investitori.					
2.1	Pastrimi i terrenit dranjë shkurret ,materiale rrothimore ,rrethoja , në gjatë perimetrit ku do të zhvillohet punimet . Në qatim kalkulohet edhe barja e materialit të demoluar deri të deponia që e cakton organ mbikqyres . Llog në m <sup>2</sup>	m <sup>2</sup>	15.50	2.00 €	31.00 €
2.2	Germimi i dheut (themelëve) i kategorisë së III-IV-të me makina ndërtimore dhe me vegla dhe. materialit i tepër i cili mbetet pas mbushjes deponohet me transport në deponinë të cilën e cakton investitori .Llog. Në m <sup>3</sup>	m <sup>3</sup>	93.00	2.00 €	186.00 €
2.3	Formësimi dhe ngjeshja e shtabazës së themelit të murit mbrojtës me ngjeshmëri 30MN/m <sup>2</sup> . Llog. Në m <sup>2</sup>	m <sup>2</sup>	27.90	2.00 €	55.80 €
2.4	Sigurimi i grupës së germuar nga rëshqitja e dheut si dhe vendëria e shenjave të sigurisë konform normave ndërtimore në fuqi .Llog. Në m <sup>2</sup>	m <sup>2</sup>	15.50	2.00 €	31.00 €
<b>Gjithsej punë II:</b>					<b>303.80 €</b>

PUNËT E MBUSHJES					
Nr.	Përshkrimi i punëve	Njësia	Sasia	Çmimi njësi me TVSH (€)	Çmimi total me TVSH (€)
3.1	Furnizimi shtirja dhe ngjeshja e tamponit 0-63mm nën bazën e themelit me trashësi t=25cm me ngjeshmëri 50MN/m <sup>2</sup> .Llog. në m <sup>3</sup>	m <sup>3</sup>	7.75	8.00 €	62.00 €
